



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4354/9 Prot.

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 19.12.2024

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 në orën 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Zejni Musaj
2. Gani Ahmetaj
3. Liljana Mesutaj
4. Novrus Toska
5. Elmira Rama
6. Vjollca Kasaj
7. Eduart Faslliaj
8. Enkeleja Ajazi
9. Erald Çepele
10. Albiona Lamaj
11. Klarida Semanjaku
12. Ertilla Myrtaj
13. Lori Musaj
14. Smerald Hazizaj
15. Klaudio Alisininj
16. Renaldo Shpata
17. Artan Velçani
18. Armand Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar specialist të administratës!

Të nderuar qytetar!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 pika 4 neni 56 pika 2 gërma a dhe rregullores.

Kourumi është me 18 këshilltarë.

Mbledhjen e deklaroj ligjërisht të hapur!

Me rendin e ditës jeni njohur por paraprakisht dua të pyes nëse ka kërkesa për të shtuar apo për të hequr pika nga rendi i ditës.

Dajana Ndoj- Po të lutem kam unë një. **Kemi projektvendim për Dhënien e dakordësisë për rinovimin e kontratës së qirasë të miratuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2024 të Këshillit të Bashkisë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier.** Objekti i kësaj kontrate është “Menaxhimi vetëm i rrugës hyrëse, peshores dhe vend-depozitimit (landfillit) të mbetjeve urbane, në impiantin e trajtimit të Mbetjeve urbane të qarkut Fier”. Neni 4 i kësaj kontrate përcakton afatin i cili fillon në datë 18.01.2024.

Armand Ahmetaj- Të lutem shumë shkurt se do prezantohet në fund.

Sipas rregullores para se të futet në rendin e ditës duhet që të votohet me 2/3 e këshilltarëve pra duhet ta hedhim në votë. Pra kush është dakord që ta hedhim në rendin e ditës.

18 vota pro asnjë kundër.

Kalojmë në rendin e ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 27.11.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 27.11.2024.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Nëntor 2024”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Nëntor 2024”.

6- Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”.

7- Projekt-vendim “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2026”.

8- Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të Kapitalit Natyror”.

9- Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027”.

10- Projekt-Vendim “Për miratimin e dokumentit “Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani veprimi 2024-2030” në territorin e bashkisë Patos.

11- Projekt-Vendim “Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2024-2025”.

12- Projekt-Vendim “Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025”.

13- Projekt-Vendim “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025”.


14- Projekt-Vendim “Për Dhënien e dakordësisë për rinovimin e kontratës së qirasë të miratuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2024 të Këshillit të Bashkisë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier.

Armand Ahmetaj- Ky është rendi i ditës që i kalon të gjitha hapat ligjore, pra që nga mbledhja e kryesisë dhe gjithë procedurat e tjera.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 18 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba



KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4354 Prot.
110

Patos më 26 .12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 27.11.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë propozim, sygjërim?

Nëse ska pyetje atëherë quhet i ezuaruar pra i miratuar.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Enkelejda Shkazi
Shkazi

Smeretol Hazizod

Yjollcor Karaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4354/11 Prot.

Patos më, 26 12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 27.11.2024

Armand Ahmetaj– Fjala për Sekretaren!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 27.11.2024 janë marrë gjithsej 6 vendime. Nga nr. 79 deri në nr 84.

Nga të cilët vendimi 81 dhe 82 u përcoll në Prefekturë dhe na ka ardhur përgjigja në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4381 Prot.
13

Patos më 26 12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Nëntor 2024”.

Fjalën e ka komisioni i Ekonomisë

Lori Musaj- Komisioni i Ekonomisë u mbledh në datën 16 dhe diskutoi mbi këtë projektvendim. Komisioni Konstaton se përmbajtja e këtij projektvendimi është argumentuar në përputhje me ligjin dhe vendosi ta miratoi pa asnjë ndryshim me 4 vota pro

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Nëntor 2024”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4382 / Prot.
13

Patos më 26 12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Nentor 2024”.

Lori Musaj- Komisioni i Ekonomisë- Gjatë mbledhjes së komisionit është diskutuar dhe kjo pikë dhe ne e kemi votuar me 4 vota pro.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Nentor 2024”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin

Miratohet me 18 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4280 / Prot.
13

Patos më 26 .12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”.

Armand Ahmetaj – Kjo pikë mer vëmendjen më të madhe. Ftoj të gjithë kolegët për sygjerimet dhe rekomanimet që do tju vij më pas.

Prezantimi i projektbuxhetit.

Mimoza Shtëmbari, Drejtore e Financës- Përshëndetje të gjithëve. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 68 për financaet e pushteti vendor dhe mbas gjithë hapave të ndjekur dhe të miratuar në këshillin bashkiak për gjithë procedurat për fillimin e hartimit dhe përfundimit të fazës përfundimtare të buxhetit vjetor 2025 dhe afatmesem 2025-2027 paraqesim për miratim projektvendimin në këshillin bashkiak dhe propozojmë:

Të miratoj Buxhetin Vendor për vitin 2025 dhe dokumentat bazë, si më poshtë :

1.1.Planin e të ardhurave për vitin 2025 shpenzimet e vitit 2025 të ardhura sipas burimeve të cilat përbëhen nga të ardhura tatimore, jo tatimore, të ardhura të tjera nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale, dhe shpenzime të ndara korrente dhe kapitale, fondi rezervë dhe kontigjentë sipas ligjit dhe fondi për mbrojtjen civile.

Pjesë e projektvendimit janë tabela e cila përmban çdo shpenzim të detajuar sipas programit dhe shpenzimeve korrente dhe kapitale që bashkëlidhen dhe i janë shpërndarë këshillit.

Tavanet buxhetore aftamesme :

Të ardhurat sipas zëreave kryesorë për dy vitet e mëparshme dhe dy vitet e PBA-së. Lista e projekteve për investime publike për çdo program sipas tabelave nga sistemi i menaxhimit të pushtetit vendor i cili është unifikuar dhe standartizuar për 61 bashki.

Numri i përgjithshëm i punonjësve sipas tabelës BV 5. Gjithashtu pjesë e projektvendimit është dhe propozimi për të miratuar shpërblimin e këshilltarëve në Këshillin e Bashkisë në masën 10% të pagës së kryetarit të Bashkisë, në masën 5% të pagës së kryetarit të Bashkisë për kryetarët e fshatrave të Bashkisë, dhe kryetarët e fshatrave të njësive administrative.

Bashkëlidhur projekt-buxhetit, relacioni me tabelat shoqëruese

Në tabelën burime financiare të buxhetit vendor 2025 prezantohen të ardhurat e buxhetit që kapin vlerën 312,582, 000 që zë 46% të buxhetit vjetor. Transferta e pakushtëzuar 228 milion me 34% si peshë specifike buxheti. Transferta e pakushtëzuar sektoriale 136 milion dhe 20% peshë specifike ndaj buxhetit total. Në prezantim është paraqitur dhe grafikë ku duket qartë që ky buxhet mbulohet më shumë me peshë specifike 46% nga të ardhurat vendore. Në tabelën që shfaqet është pasqyruar peshë specifike e të ardhurave, investimeve ndaj planit të buxhetit total. Dhe kemi 312 milion të ardhurat dhe 46% ndaj buxhetit total, kemi 23 % shpenzime kapitale ndaj buxhetit total dhe një nga treguesit kryesor është që bashkia vazhdon për 6 vite radhë të jetë me 0 detyrime të prapambetura. Në tabelën që shfaqet është shpërndaja e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik i cili tregon 44% të shpenzimeve të buxhetit i zënë pagat, 8.23 sigurimet shoqërore, 21% shpenzime operative, 0.63% fondi për mbrojtjen civile, 0.91% fond rezerve/ kontigjence, dhe 23% shpenzime për investime. Në tabelën e shfaqur tregohet si kanë qënë burimet për 2024 si janë për 2025, krahasimi midis këtyre 2 viteve, ndryshimi në vlerë absolute në përqindje që kemi një rritje 18% të transfertës të pakushtëzuar, 16% sektoriale dhe 5% të ardhurave lokale. Kemi një rritje totale 12% të vitit 2025 ndaj vitit 2024. Në tabelën e shfaqur janë të gjitha shpenzimet sipas programeve ku tregohet se ne buxhetojmë më 17 programe dhe këto programe mbulojnë të gjitha funksionet sipas ligjit 139. Prioritet dhe fokusi janë:

- Zhvillimi urban
- Zhvillimi i arsimit të kulturës
- Zhvillimi bujqësor
- Shërbimi social

Kryetari i Bashkisë- Përshëndetje!

Pak a shumë për pjesën e realizimit të të ardhurave besoj se ky vit do të jetë një ndër vitet më të mira në realizimin e të ardhurave vendore. Besoj se vitin tjetër shpresoj të jetë akoma më i mirë se ky vit. Përsa i përket përmirësimit të infrastrukturës për vitin 2025 janë parashikuar në total 47 rrugë të rehabilituara me një sipërfaqe prej 49,749 m² shtohen nga investimi me Asfaltobeton të cilat përfshijnë

- 25 rrugë në Njësinë Administrative Patos
- 16 rrugë në njësinë Administrative Zharrëz
- 6 rrugë në Njësinë Administrative Ruzhdië

Raporti është ndar dhe në afërsi të banorëve që ka secila njësi dhe të nevojave që ato kanë.

Në zharrëz janë Rruga “Grëmballarët”, Doganëve, “Mjerakët”, Rruga Kiklat”, “Bahaj”, Në fshatin e Ri janë Rruga “Pëllumbaj”, “Ngjeliu”, “Demollarët” në Verbas Segmenti 8 Dhjetori, janë dy segmente Segmenti 8 Dhjetori , Rruga Prendajt, Rruga Pusi, Rruga Ferrajt, Rruga Hoxhajt, Rruga Lejleket (Vazhdim).

Në Patos kemi rruga Kodër, rruga Alush Noga, Rruga “Luigj Gurakuqi”, Rruga “Luigj Gurakuqi”, “Muharrem Muho”, “Aksioni i Patosit”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Rruga “Njazi Çala”, Rruga “Njazi Çala”, Rruga “Edit Durham”, Rruga “Perikli Prifti” Sheshi tek blloku parafabrikat , Segmenti i rrugës “Enriko Veizi” Kryqëzimi i rrugëve “Kryengritja e Fierit dhe Kisha e patosit pjesa mbas Gjermanit. Rruga Batalioni Camëria, Rruga Enriko Veizi, rruga e parë është një segment që ngeli të rruga e vreshtit është një diferencë shumë e shkurtër që nuk ishte e përfshirë tek investimi. Rruga Enriko Veizi edhe kjo bën mbylljen nga arena e cirkut me rrugën që bën lidhjen për të shkuar në lagjen e re, Rruga “Dhimiter Deda” , “Qerim Banaj” Rruga “Shperdhese” Rruga kryqezim i rrugeve Marko bocani dhe Servet Jasini, “Xhelaj” Rruga “Stanislav Zuber”, Rruga “Rasim Halimi, vazhdim rruga Burim i Xanes”, Deshmoret e Prishtines”, Rruga Rrapi Tiku dhe Sotir Xoxe Segmenti i rrugës “Degezim Late Bregu”.

Rruga "Malaj" Pranë qendres Shëndetësore Rruga e Kasnices, Rruga Xhoraj vazhdon deri ne rrugen Hysaj, Rruga "Cukuvraj", Rruga "Myftaraj", Rruga «Ymeraj, rruga e gjynaqarës".

Ka filluar Rikualifikimi i bllokut përpara pallatit të Kulturës në Lagjen Naftëtari .

Nga zbatimi i këtij projekti shtohen:

- 2400m² rruge të rehabilituar
- 1450m² sipërfaqe e gjelbëruar , hapësirë rekreacioni(kënde lojrash), ndriçim
- 250 ml KUZ, KUB
- Përfituesit janë banorët e lagjes Naftëtar.

Vlera e këtij investimi është e ndar në dy vite, viti 2024 është 9,904,000 viti 2025 është 47,000,000 me tvsh.

Aktualisht jemi në fazën e hartimit për gjithë projektin e lagjes 1 Maj, përfshinë gjithë pjesën që është poshtë rrugës Koli Marku. Do rehabilitohen komplet qendra e lagjes 1 maj. Do parashikoht në projekt dhe ndërtimi i një mini qendre të vogël. Është rruga që shkon për te kopshti dhe rruga që del për te posta që me disa ndryshime do ti parashikojmë për tu bërë vitin tjetër duke qënë se mund të kemi disa ndryshime te marrëveshja kuadër për efekt të një investimi që presim të vij nga fondi Shqiptar Zhvillimit. Më këtë mbyllet lagja 1 Maj. Me investimin para këtij mbyllet lagja Naftëtari, të lagja Naftëtari ngel një segment shumë i shkurtër, mbas shkollës Muhamet Shehu që do e shohim në 2025. Besoj se deri në fund të vitit të ardhshëm në të gjithë pallatet që janë në Patos kur të zbresin qytetarët nuk do ketë më baltë.

Sistemimi i sheshit të kopshtit në Belinë

Sistemimi i shesheve në lagjen Naftëtari (pjesa e mbetur)

Sistemimi i shesheve në lagjen 29 Marsi (afër Hekuran Manekut)

Rikonstruksioni i trotuarëve në rrugën "Sulo Goxhaj".

Nga zbatimi i projektit "Ndërtim te trotuarëve dhe Shesheve te pallateve " shtohen:

10 sheshe të rehabilituara

Përfituesit, banorët e zonës. Akoma vazhdojmë dhe këtë vit, deri tani mund të jenë rehabilitaur me shumë se 30 hapësira publike poshtë pallateve.

Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re që është parashikuar pjesa e mbetur që mbyll investimin që është aktualisht që mbyll pjesën jugorë të lagjes, fillon dhe pjesa veriore i cili është i shtrirë në dy vite. Në vitin 2024 16,389,000 dhe në 2025 32,953,000

Nga zbatimi i këtij projekti shtohen:

- 2350 ml rrugë të rehabilituar ,
- 300 m² trotuare,
- 750 ml KUZ, KUB

Përfituesit: banorët e zonës Vresht

Kemi parashikuar dhe Rikonstruksion i shtresës së asfaltit për rrugët:

- Sulo Goxhaj
- Heronjtë e Linasit

Vitin e ardhshëm do parashikohet vetëm pjesa e sipërme asfaltike për të dyja rrugët

Investime që përfundojnë zbatimin në vitin 2025 kemi lotin e dytë dhe lotin e tretë

Rikonstruksioni i rruges tek Lagjja e Re, përroi Çam.

Rehabilitimi i përroit.

Shtimi i flotës së mjeteve në Agjencinë e Shërbimeve Publike

Investime nga Qeveria Qëndrore

Rikonstruksioni i rrugës “Patos-Lagjja Mustafa Matohiti” e, “Oficinës” Fasadat e pallateve, blloku nr. 1 që do të shtohen.

Shëtitoret anës përroit, baza materiale ka ardhur dhe shume shpejt do të fillojnë punimet, do filloj në janar dhe do mbaroj në një hapësirë 3-6 muaj. Do jetë një shëtitore që do të filloj në rrugën Gani Banaj dhe do të përfundoj të ura që lidhet me pjesën e vreshtit me pjesën tjetër të lagjes së Re. Ideja është që do vazhdojë të lidhet dhe te pompa dhe do vazhdojë të dali deri te pallati Francez.

Rikonstruksioni i rrugës së Belinës

Mobilimi i kopshtit me drekë, Patos

Rikonstruksioni i shkollës Sotir Çapo, Zharrëz presim konfirmimin nga Ministria e Arsimit.

Ndërtimi i rrjetit KUN në lagjen 29 Marsi dhe fshatin Grizë Velaj dhe Grizë Lenginas

Rehabilitimi i skemës vaditëse rezervuar Zharrëz

Konceptimi i ri i skemës segmenti zharrëz, me furnizim nga lumi Seman

Krijimi i parkut Frashër-Sheqishte

Rikonstruksioni dhe adaptimi në stacionin e repartit të Shërbimit Zjarrfikës

Rikonstruksioni i shkollës Hekuran Maneku. Shume shpejt do fillojmë me hartimin e projektit që të jemi gati për në janar që fillojnë dhe aplikimet.

Zhvillimi i zonave periferike të qytetit.

mbjellje pemësh dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara

shtirje e ndricimit rrugor në të gjitha zonat problematike,

mbulim me menaxhimin e mbetjeve etj

Rikonstruksioni i Kopshtit me drekë, Patos që besoj do prokurohet që këtë vit dhe do përfundoj në fundin e gjashtëmuajorit të parë të vitit të ardhshëm.

Te pjesa kulturore e aktiviteteve ne do vazhdojmë me aktivitetet që kemi pasur gjatë këtij viti ,3 festat e qytetit, do shtohen dhe disa të tjera do kemi më shumë hapësirë te pjesa e teatrit siç janë:

shfaqje nga teatri kombëtar

shfaqje stand up Komedi

3 shfaqje të dedikuara për fëmijë

Dita e rinisë

- Ceremonia zyrtare dhe përkujtimore të datave historike
- “Jo vetëm lule”
- Pasurimi i bibliotekës me libra
- Gjithmonë pranë jush – i dedikohet moshës së tretë

Me mbylljen e shëtitores të lagja e re do bëhet dhe rehabilitimi i fushës,

ZHVILLIMI BUJQËSOR

Blerje traktor me agregat për mirëmbajtjen e kanaleve kullues dhe vaditës

Realizimi i aplikimeve në grup nga fermerët për përfitimin e granteve të ndryshme Shërbimi i këshillimit dhe ofrimi i shërbimeve bujqësore për 4135 fermerë.

Mbështetje e fermerëve për promovimin e produkteve bujqësore e blegtorale të zonës

20 fermerë të mbështetur financiarisht nga skemat e Bashkisë.

Ndërhyrjen në sistemin e kullimit, vaditjes, sistemin e rrugëve të parcelave,

Shtim i rehabilitimit të 15 km kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese .

11 rrugë parcleash të hapura dhe të shtruara për fermerët për një akses më të lehtë të produkteve blegtorale të zonës me tregun.

Ne do të fillojmë në Sheqishte siç e kemi thënë, jemi në procedurë për blerjen e bazës materiale për ndërtimin e dy stacioneve të vaditjes të cilat do të shtohen dhe me një ose dy të tjerë për pjesën tjetër të Sheqishtes dhe besoj se vitin e ardhshëm i mbyllim edhe deri diku pjesën e Sheqishtes për

vaditje. Ndërtimi i stacionit të ujit është duke u përfunduar është parashikuar për ndërtim dhe një tjetër stacion në Belinë dhe me këta të dy mbyllet komplet pjesa e vaditjes.
Përsa i përket rrugëve të parcelave bujqësore një pjesë të mirë do fillojmë që tani me çakull, vitin tjetër kemi parashikuar akoma më shumë me çakull dhe normalisht do vazhdoj hapja e parcelave bujqësore.

Përsa i përket mbrojtjes së mjedisit

Monitorim i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz
Shërbimi DDD
Konkurs midis shkollave
Dita e Tokës
Dita Botërore e Mjedisit
Dita Ndërkombëtare e Mbjelljes së pemëve

Përsa i përket Shërbimit Social

Bashkëfinancimi i projektit “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunktionale”
Financohet nga Ministria e Shëndetësisë (70%) dhe Bashkia Patos (30%)
Shërbimi ofrohet 8 orë
Përfituesit: 18 fëmije, moshë 5-20 vjeç

Integrimi evropian

dita për mbrojtjen e të dhënave personale
dita ndërkombëtare e parandalimit të ekstremizimit të dhunshëm
dita e tolerancës
aktivitete me qëllim informimin lidhur me BE dhe rrugën e shqipërisë drejt BE
workshop mbi lidërshtipin e të rinjve
workshop me të rinjtë lidhur me gjithëpërfshirjen në punësim dhe edukimin në karrerë
aktivitete në kuadër të planit local të veprimt për rininë 2024-2026
Armand Ahmetaj – fjalën e ka kryetarja e Komisionit të Ekonomisë
Lori Musaj Kryetare e komisionit të Ekonomisë
Përpara se ta hedhim në votim projekt buxhin e vitit të ardhshëm të bashkisë Patos doja të sillja në vëmendje shumë pak nga këto momente që ne sot na bëjnë jo vetëm të bindur për rezultatin final por dhe të krijojmë një frymë të re bashkëpunimi për të mirën e vendit tonë. E kemi diskutuar gjatë mbledhjen e komisionit të Ekonomisë këtë buxhet ku kemi trajtuar me detaje çdo zë dhe ndikim të mundshëm kemi diskutuar gjatë dhe efektet e tij tek qytetarë dhe biznesi dhe ndihem krenare që sot jemi të gjithë bashkë në të njëjtën anë për të hedhur këtë hapë për Patosin dhe familjet tona për këtë duhet të falenderoj ekzekutivin e bashkisë që ka bërë një punë të lavdërueshme duke marrë kërkesat emediate të qytetarëve dhe i ka përkthyer ato në investime konkrete duke mos lënë asnjë territor apo target grup qytetarësh pa përfshirë në këtë.
Ky është një buxhet gjithëpërfshirës vijimi reformave që kanë nisur gjatë viteve të fundit mbetet një prioritet për ne me qëllim që të krijohet një klimë ekonomike dhe sociale qëndrueshme ku qytetarë të kenë mundësinë të shijojnë përfitime konkrete nga përpjekjet e bashkisë Patos nuk dua të ndalem në të gjitha investimet që përfshinte buxheti po duhet të shpreh falenderimet e mia për investimet të bërë në lagjen Naftëtari cili është investim i shumë pritur nga qytetarë dhe i merituar si kryetare e komisionit të ekonomisë kërkoj nga kolegët këshilltarë ta miratojnë këtë projekt buxhet
Ne e kemi votuar në katër vota pro.
Faleminderit!

Refaela Xeba- Për një saktësim- Nga njohja me rendin e ditës Prefektura na ka bërë me dije se duhet të saktësohet titulli ku të hiqet pjesa e numrit të përgjithshëm të punojësve pasi kjo është e parashikuar në brendësi. Pra titulli do të mbetet Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 dhe dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”.

Armand Ahmetaj- Pra nga të gjitha komunikimet që kemi bërë me Prefekturën ky do të mbetet titulli i projektvendimit që më pas të bëhet vendimi.

Mimoza Shtëmbari- titulli i projektvendimit nuk është se është paraqitur këtu gabim, e ka kërkuar vet prefektura dhe ne e dinim që numri i përgjithshëm nuk duhej në titullin e projektvendimit ata insistuan dy vjet në 2023 dhe 2022 dhe sot vijnë me mesazhin që duhet hequr. Nuk është se ne e kemi paraqitur titullin e projektvendimit në mënyrë të gabuar por thjesht është një rregullim.. Fiks me ligj është miratimi i buxhetit vjetor i cili përmban dokumentin përfundimtar të PBA, nr e përgjithshëm, e të gjitha me radhë por jo në titull.

Armand Ahmetaj- Nuk ndryshon përmbajtja ndryshon vetëm titulli i vendimit.

Eduart Faslliaj- Meqë jemi këtu ka ndryshime në numrin e përgjithshëm të punonjëve?

Kryetari- Jo vetëm në shtimin e 10 punëtorëve të përkohshëm.

Erd Çepele- Tek raporti BV5 ku është numri i punonjësve të bashkisë dhe numri i punonjësve të Bgjencisë 371, mos duhet shtuar dhe numri i 10 punonjësve që ne do miratojmë sot?

Mimoza Shtëmbari- Po ta shikosh ka numër të përgjithshëm dhe numër me kontratë. Në kushtet që jemi ne nuk e kemi miratuar.

Novrus Toska- Kam dy pyetje. E para është lidhur mesa dëgjuam për buxhetin nuk është artikuluar më parë problemi vazhdimi të projekti të KUZ të Verbasit nuk e dëgjuam a e ka bashkia kryetari në planet e tjera në të ardhmen? Dhe dyta lidhur me bujqësinë për sistemi në vaditjes skemën e kurjanit për këto tjerat unë jam plotësisht dakord dhe ishte shumë i detajuar buxheti me skemën e Kurjanit bashkia çfarë përpjekjesh po bën dhe ato do mbushen kanalet sivjet me ujë për fshatrat Novosel, Verbas Frashër se Sheqishtja po mendohet që do të bëhen investime të tjera Faleminderit!

Elmira Rama – Përshëndetje, unë së pari dua të kërkoj ndjesë nëse kam pasur mungesë të vëmendjes por në lidhje me infrastrukturën rrugore të njësisë administrative Zharrës nuk dëgjova për ndërhyrje në arterien që lidh fshatin Frashër me tokat bujqësore është një segment rrugor që unë e kam sjellë në vëmendje falënderoj që është ndërhyrë për mbushjen e gropave atje ku ka qenë më emergjente por kemi kërkuar shtrimin e rrugës me një material paksa më të imët sepse akoma banorët kanë vështirësi dhe jo më larg nga mbrëmë unë kam pasur takim me një banorë që e ka ripërsëritur kërkesën për këtë rrugë.

Vjollca Kasaj- Përshëndetje të gjithëve mesa dëgjova në projektuxhetin për vitin që vjen për rehabilitimin e lagjes 1 Maj e përgëzoj kryetarin që do ndërhyjë në lagjen 1 Maj sepse është investim shumë i nevojshëm për atë lagje dhe kanë nevojë për ndërhyrje plotësisht por do të dija nga ana e bashkisë a do të bëhet edhe veshje e fasadave të pallateve në pjesën e unazës sepse ato pallate janë shumë të vjetra janë të viteve 67 dhe besoj se termoizolimi duhet të kishin filluar nga pallate më të vjetra dhe jo nga pallate të reja që kishin një lloj izolimi të jashtëm.

Eduart Faslliaj- Doja të dija ishte një vlerë diku te ndoshta 300 milion investime që ne i kemi paralizuar nga buxheti i vitit 2024 që janë parashikuar për tu bërë shtesë në buxhetin e këtij viti në mos gabo. Doja të dija kush ishin investimet që nuk janë realizuar, kush kanë qënë arsyet dhe një sqarim desha një nga ato investimet që është parashikuar në vitin 2025 për lagjen Mustafa Matohiti ishte vazhdimi i segmentit për tek rruga burimi i Xanës doja të dija me çfarë shtimi do bëhet dhe për ku bëhet fjalë ekzaktësisht dhe kujt do ti shërbej ai lloj investimi?

Kush ka qënë qëllimi që është përzgjedhur?

Erald Çepele- Për këtë vit në buxhetin e 2024 ishin parashikuar disa rrugë dhe unë prisja që në 2025, kam adresuar dy rrugë që janë të ish stallat në Verbas dhe rruga që është te lagja e Lacemit që është mbrapa shtëpisë se bardhë. Nuk dëgjova këtu për rehabilitimin e fushës së sportit në Verbas që është bërë një premtim nga ana juaj. Jo vetëm të Verbasit por edhe të Frashërit.

Nuk e di çfarë është menduar në lidhje me këtë pjesë. Një problem tjetër është rruga e Majmërisë kërkon ndërhyrje emergjente me stabilizantë. Të shtohet fondi për rrugët rurale. Verbas prej muajsh nuk ka infermier, do këtë një protest shumë shpejt nga ana e qytetarëve në lidhje me këtë pjesë.

Mimoza Shëmbari- Përsa i përket pyetjes për moralizim të buxhetit 2024 për një vlerë 3 milion që ishte pyetja atëherë ndërkohë edhe për pyetjen tjetër që ishte për ato që kanë filluar dhe janë parashikuar për vitin 2024 dhe nuk kanë filluar ose nuk kanë përfunduar sqaroj që për buxhetin 2024 ne vazhdojmë të mbyllim dhe të zbatojmë ato angazhime dhe ato shpenzime dhe objekte që kemi miratuar me vendim këshillin për 24 për realizimin e buxhetit 2024 ne vijmë në shkurt në janar ose shkurt sipas akt akordimit me degën e thesarit për miratimin e buxhetit faktik për raportimin e atyre angazhimeve që ne kemi realizuar dhe ato që nuk janë realizuar dhe arsyet pse nuk janë realizuar por sot ne kemi ardhur dhe kemi propozuar për miratim të buxhetit vjetor në 25 dhe PBA 2025-2027 dhe për 2024 ne do raportojmë janar shkurt për mos realizimet ndërkohë jemi duke realizuar dhe një nga pika të vendimit të 2025 numër tetë tek projekt vendimi është pasqyruar në projektvendim që ne fondet e angazhuara të miratuara për 24 do t'i kalojmë po prapë nuk buxhetin 2025 por që të mbulojnë angazhimet e 2024 do vazhdojnë ne kemi shumë kontrata të lidhura të cilat janë në proces zbatimi të papërfunduara të cilat do kalojnë si angazhime të 24 por që do përfundojë në 25.

Kryetari i Bashkisë - Faleminderit po filloj nga fillimi nga vaditja nga rezervuari i Kurjanit, kam përshtypjen se nga Bashkia e Roskovecit po bëhet një investim nuk e di kanë filluar apo jo por di që është parashikuar si investim për mbushjen e rezervuarit nga kënetat e zezë. çdo gjë do të varet nga kjo.

Përsa i përket rrugëve në Frashër sidomos në rrugët e parcelave ne kemi parashikuar dhe në Frashër është bërë ndarja e barabartë si njësitë e tjera. Nuk është pjesë e buxhetit tonë por është e Bankersit. Investimi i Bankersit do bëhet çdo vit në një fshat të ndryshëm.

Përsa i përket Kuz në Verbas është një investim që bëhet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizim, nuk është investim që bëhet nga bashkia. Ne kemi ndërhyrë me disa ndërhyrje të vogla në Verbas, një pjesë të lagjes e kemi bërë këtë vit.

Përsa i përket fasatave të pallateve në unazë, prioritet nr. 1 në pallate fasat janë pallatet parafabrikat nëse do zgjidhet të vendoset prioritet gjithmonë do zgjidhen të parët pallatet parafabrikat pastaj janë pallatet e tjera prandaj ka filluar pallatet parafabrikat dhe normalisht do të vazhdojë edhe pjesë të tjera të qytetit prioritetet do të jëtë lagjja Naftëtari dhe lagjja 1 Maj për periudhën aktuale, tani do bëhet hatimi I projektit dhe besoj se mbaron në fund janarit duke qënë se është një sipërfaqe shumë e madhe dhe projekti është bërë nga të tret nuk do bëhet nga drejtorja e projekteve në bashki. Nëqoftë se vlera do të jetë e tillë që do të ketë mundësi për ndërhyrje të fasatave në lagjen 1 Maj do të bëhet ndërhyrje nga vet bashkia dhe për pjesën tjetër do të kërkohet siç e kemi apilkuat te fondi Shqiptar i Zhvillimit ku ne kemi aplikuar për fasadat e pallateve për 100% të pallateve që janë në Patos.

Përsa i përket rrugës burimi i Xanes besoj se një rrugë më shumë nuk prish gjë. Duhet ta shoh.

Përsa i përket fushës së sportit në Verbas do shohim mundësinë e ndërhyrjes unë nuk di ta kem premtuar por gjithësesi do shohim pasi aty është kërkuar nga banorët që edhe të bëhet edhe tregu që është në Frashër të bëhet atje.

Përsa i përket rrugës tjetër Majmërisë që duhet ndërhyrë më stabilizantë do shohim por kam përshtypjen që është parashikuar te rrugët që do ndërhyet me çakull ne qoftë se jo do jetë për vitin tjetër.

Tek fondi i shtrimit me çakull këtë vit ka qënë 1 milion e 800 vitin tjetër është 2 milion e 800.

Tek fondet e trashëguara që janë për vitin tjetër ka filluar punën Drejtorja e Projekteve për rrugën e Kripallarëve. Dhe tjetër është ruaga te pompa që bëhet lidhja me pallatin Francez që bëhet lidhja dhe me rrugën e Re që do filloj nga vreshti.

Investimet deri në 31 dhjetor do të jenë o në faze prokurimi ose në fazë lidhje kontrate 100%.

Do prokurohet kopshti shumë shpejt edhe pjesa e bllokut të lagjes Nafitëtarë do prokurohet këto ditë. Këto janë që nuk kanë qenë tek pjesa e realizimit investimeve që të bëhen këto ditë. Pjesa e vonësës së tyre është se çdo projekt i nënshtrohet oponencës ka dhe vonesa të pjesa e oponencës së projektit.

Për të bërë projektin e lagjes Nafitëtarë janë dashur më shumë se 5 muaj për faktin se ishte gjithë blloku i pandërrë dhe ishte në gjendje shumë të keqe edhe topografët ishte pamundur bënë matjet për shkak të ferrave, kallameve që donin ndërhyrje për pastrimin e atyre që të filloni për të bërë projektet të njëjtën probleme kemi pasur edhe me projekte të tjera duhet të ndërhyhnim njëherë me pastrimin rehabilitimin dhe më pas të hartonim projektin.

Tek lagja e re që u bë aktualisht anës Përroi u bë projekti për rrugën kur filluam të pastronim kanalën na doli një hapësirë që u hap një hapësirë e paparashikuar.

Për pjesën e premtimit çfarë kam premtuar në 2023 besoj do mbyllet në 2025, mund të ngelet ndonjë gjë e vogël.

Smerald Hazizaj -Përshëndetje të gjithëve!

Unë problematikat dhe shqetësimet të lagjes Mustafa Matohiti – Margëlliç dhe Rerës i kam ngritur më herët në komisionin Ekonomisë dhe nuk doja të përsërisja përsëri. Mora shkas këtu nga kolegu parafolës i cili foli për për rrugën e burimit të Xënës ajo rrugë unë doja të theksoja që ajo rrugë nuk i shërben vetëm një individ i ajo rrugë shërben katër bizneseve private, i shërben një komunitetit të gjerë me një numër familje rreth 150, është një rrugë e nga hershme e kërkuar nga lagja Mustafa Matohiti është rruga e ish dyqaneve si një nga lagjet më të vjetra të Mustafa Matohiti si rrugë e ish dyqaneve dhe nuk i shërben një individ por një numër banorësh rreth 200.

Unë e përgëzoj bashkinë Patos e cila e ka vendosur në plan për ta futur në investim njëkohësisht dhe rrugën e Rrapushave, marrë shkas të falënderoj edhe qeverinë shqiptare investim shumë të madh që po vjen për lagjen Mustafa Matohiti sic është rruga Patos -Mustafa Matohiti dhe njëkohësisht rrugën Mustafa Matohiti- Oficinë e vjetër.

Për Mustafa Matohiti kanë ardhur shumë investime siç janë të gjitha rrugët dytësore të gjitha lagjeve në këto dy rrugë kryetar që ne po vijmë me investim për vitin 2025 numri I rrugëve në Mustafa Matohiti sa vjen dhe reduktohet dhe ngelen vetëm rrugica të cilat ishte shërbejnë 3 deri në 4 familje.

rruga e burimit të xanave është rruga që shumë shumë mirëpritur dhe besoj dhe siguroj që qytetarë të tij janë mjaftueshëm shumë të kënaqur për atë rrugë sepse do ta bëjë më të lehtë hyrja dhe daljen në shtëpi.

Eduart Faslliaj- Të bëj një saktësim se ndoshta smeraldi ka të drejtë ndoshta emri që ishte vendosur nuk përcaktonte vendndodhjen e rrugës unë pata idenë se duhet të ishte një segment rrugor tjetër nëqoftëse bëhet fjalë për segmentin që lidh rrugën kryesore me rrugën në drejtim burimit të xanës sepse burimi xanës nga aty është një tre kilometra tjera dhe nuk e di pse keni emërtuar kështu formën, nëse u bëka fjalë për një rrugë që është brenda lagjes nga rruga kryesore dhe në drejtim të burimit të xanës ai ka drejt i shërben komunitetit dhe jemi ok.

edhe meqenëse jemi këtu 1 pyetje kisha kryetar ju thatë se aty janë parashikuar mbështetje për 20 fermerë nga buxheti bashkisë si janë përzgjedhur?

Kryetari Bahkisë- Shpallja do bëhet publike shpallet të faqja e webit. Është e hapur për këdo që plotëson kriteret.

Eduart Faslliaj -Kemi aplikuar përpara disa viteve, janë një kategori banorësh të lagjes Mustafa Matohiti, Margëlliç po ndoshta dhe të Rusinjës të cilët janë të pajisur me dokumentacion mbi pronësinë e tokës bujqësore. Kemi aplikuar për tu njohur bazuar në ligjin e atëhershëm. Çfarë është bërë sepse atyre fermerëve nuk u vilet asnjë lloj takse? Nuk janë as banor të pronës de jure se de facto janë.

Kryetari i Bashkisë- Nga ana e bashkisë në kemi kërkuar gjithë zonat që nuk kanë qenë të paazhornuara nga kadastra. Tani presim nga Kadastra.

Erald Çepele- Unë nuk mora përgjigje për qendrën shendetësore dhe për rrugën e Laçenjëve.

Kryetari i Bashkisë- Qendra Shendetësore është në proces kolaudimi ndërsa Rruga e Laçenjëve duhet ta vlersësojmë, ta shohim në vend.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 dhe dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”.

Miratohet me 16 vota pro, 1 kundër , 1abstenim .

SEKRETARE
Refaela Xeba



Entekudja Haxhi
Haxhi

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Smeylly Hazret
Hazret

Vjollca Baxhi
Baxhi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 433 Prot.

13

Patos më 26 12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2026”.

Ekzekutivi relaton materailin

Mimoza Shtëmbari- në zbatim të ligjit të finanacave të vetëqeverisjes vendore dhe udhëzimit për përgatitjen dhe ndjekjen e procedurave standarte të hartimit të buxheteve afatmesëm paraqitet për miratim kalendarit dhe përmban gjithë fazat e përgatitjes dhe hapat që ndiqen në projekt buxhetin afatmesëm për tre vitet 26-28 dhe të buxheti vjetor 2026 dhe këto kanë të bëjnë që në fillim në shkurt faza e parë është me vlerësimin e të ardhurave për tre vitet e buxhetit afatmesëm të ardhshëm pastaj vazhdoi me përcaktimin e taveve prioritare dhe programeve prioritare.

Vazhdojmë me miratimin e buxhetit me dokumentin e parë të PBA-së pastaj rishikim të taveve miratimin dhe propozimin për miratim të taveve përfundimtare dhe kërkesave të rishikuara të buxhetit pastaj Nëntor paraqitja dhe përgatitja e buxhetit 2026 dhe buxhetit përfundimtar 2026 – 2028 afatmesëm, të gjitha hapat janë të shoqëruara në shtojcën që shoqëron projekt vendimi kalendarit i buxhetit afatmesëmi 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026.

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë ku ne e kemi votuar me katër vota pro .

Larguar nga mbledhja këshilltari z. Klaudio Alisanaj dhe Klarida Semnajaku.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim “Për Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2026”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4333/3 Prot.

Patos më 26.12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të Kapitalit Natyror”.

Ekzekutivi relaton materailin. Përshëndetje të gjithëve!

Orges Gollosi- Drejtor i Bujqësisë- Në fakt drafti i Raportit të Vlerësimit të Kapitalit Natyror nuk është i detyrueshëm por është një draft që përmirëson treguesit e performancës së bashkisë në ofrimin e shërbimeve drejt qytetraëve. Ky draft është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 139, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe VKM-ja nr. 252, datë 20.04.2023 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030,

Siç mund ta keni vënë re drafti është i gjerë dhe gjithëpërfshirës ku përmban të dhënat e bashkisë Patos, Kapitalit të saj natyror ku mund ta shikoni tabelën përmbedhëse në fund. Fluksi monetar I parashikuar dhe i vlerësuar në draft, metodika e llogaritjes është bërë në asistencë të OSBE-së ndërsa drafti është hartuar nga ekzekutivi i bashkisë Patos. Fluksi monetar vjetor të cilin ne e kemi llogaritur është 32 miliard e 318 milion e 505 mijë ndërsa vlera e këtij viti monetar është 169 miliard e 907 milion e 388 mijë.

Në brendësi të draftit do të gjeni një sqarim të gjerë mbi metodat dhe informacionet e marra ku janë përfshirë zonat industriale, tokat bujqësore, pyjet. Të gjitha këto të dhëna janë marrë nga institucionet përkatëse.

Armand Ahmetaj- Edhe kjo pikë ka kaluar në komisionin e bujqësisë dhe është votuar me vota unanime.

Erald Çepele- Çfarë peshe zë në kapitalin natyror lumi Seman?

Orges Gollosi – vlerësimet në kapitalin natyror të lumit Seman është bërë vetëm për pjesën,vijën të cilën prek territorin e bashkisë Patos dhe metoda e llogaritjes është në fuqinë vaditëse që kemi në lumin Seman sipërfaqe që mbulon pjesa e vaditjes dhe vlera e tarifës vaditëse është parashikuar në Paketën Fiskale dhe është bërë përmbledhja për të vlerësuar kapitalin natyror sepse lumi Seman përfshin më shumë se tre bashki në gjatësinë e tij dhe vlerësimi bimeve dhe pyejeve është bërë në bazë të lëndës drusore ore në bazë oksigjenit dhe dioksidit që prodhon me formulat përkatëse. në këtë duhet të kuptojmë vlerësimin kapitalit është bërë nëse përshëmbull nëse burimet natyrore bashkisë Patos do të jepeshin me qera.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të Kapitalit Natyror”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4391 Prot.

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027”.

Armand Ahmetaj- Edhe kjo pikë ka kaluar në komisionin e Bujqësisë dhe është votuar me vota unanime.

Ekzekutivi relaton materailin, Orges Gollosi- Drejtor i Bujqësisë-Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 139, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, ligjin nr. 9817/2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” si dhe VKM-në nr. 460, “Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021–2027”, është hartuar Planin Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027, i cili kaloi dhe në konsultim publik me grupet e interesit në datën 11.12.2024.

Në këtë plan kemi bërë një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve bujqësore si dhe pasqyrim të situatës aktuale të sistemit ujitës dhe kullues. Gjithashtu është analizë të problematikave si dhe kemi përcaktuar objektiva për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor.

Objektivat e planit përfshijnë një dimension të gjerë politikash për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor si Qartësimin e së drejtës së pronës Investime në infrastrukturë, Mbështetje financiare të drejtpërdrejta ose jo, Mbështetje për zhvillimin lokal gjithëpërfshirës, Forcimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmarrja e veprimeve për klimën, Sigurimi i të ardhurave të qëndrueshme për fermerët dhe rezistenca ndaj presioni të tregut.

Për arritjen e qëllimit kryesor të këtij plani, i cili është të promovojë një sektor bujqësor të qëndrueshëm, produktiv dhe konkurrues, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë miratimin e këtij plani

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “ Për miratimin e Planit lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Enkelejda Arzi

Smeraldo Hoxhi

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 42891 Prot.
/3

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-Vendim “Për miratimin e dokumentit “Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani veprimit 2024-2030” në territorin e bashkisë Patos.

Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit-

Kryetari i Bashkisë- për pjesën e rrugës burimi Xanës- (tregon hartën)

Eduart Faslliaj- Kryetar një sqarim, nuk është burim i Xanës. Burimi i Xanës është në Margëlliç kështu që ndryshoje emrin.

Kryetari i Bashkisë- Emrat janë vendosur 100% . Do ta shohim dhe këtë pjesë

Eduart Faslliaj- Unë them që burimi i Xanës është në Margëlliç, ndryshon dhe përcaktimi dhe nuk i shërben asgjë gjëje ndaj u habita.

Kryetari i Bashkisë- Ndaj jua solla harten por këtë gje ti mund ta propozosh

Eduart Faslliaj- Jo është gabimi juaj

Kryetari i Bashkisë- jo nuk është gabimi jonë, në ASIG ashtu është .

Eduart Faslliaj- Jam dakord për investimin, nuk më vjen mirë që do bëhet në prag të fushatës , duhet të ishtë bërë me kohë dhe skëni pse e shtyni as atë as rrugën tjetër se nuk do tju shërbejë për të marrë asnjë votë se 200 banorë si ka gjithë lagja dhe ata janë pensionist dhe nuk votojnë më për ju se nuk ju del pensioni.

Arben Shpërdheja - Relacion për miratimin e dokumentit “strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani veprimit 2024-2030” në territorin e bashkisë patos

Qëllimi : Hartimi i dokumentit "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2024-2030", në territorin e Bashkisë Patos, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

1. Bashkia Patos me qëllim hartimin e dokumentit "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2024-2030" sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", miratoi Urdhrin nr. 12, me nr. 203 prot., datë 24.01.2024 , ndryshuar me Urdhërin nr. 52, me nr. 203/2 prot., datë 13.03.2024 "Për krijimin dhe funksionimin e Grupit Teknik në nivel Bashkie për procesin e hartimit të Dokumenteve Strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planit vendor, në nivel Bashkie", me grupin teknik të punës që ngarkohej që të punonte për hartimin e këtij dokumenti.

2. Në hartimin e këtij dokumenti, Grupi Teknik në nivel Bashkie për procesin e hartimit të Dokumenteve Strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planin vendor 2024-2030,

në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Prefektit të Qarkut, u mbështet nga kompania konsulente në kuadër të projektit RESEAL të UNDP.

3. Gjatë periudhës së punës së këtij Grupi Teknik:

U grumbullua gjithë informacioni i nevojshëm mbi risqet e mundshme nga përmbytjet, tërmetet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, ndotjet teknologjike dhe industriale dhe risqet biologjike që janë prezentë në territorin e Bashkisë Patos.

U bë studim i gjithë zonave me risk të shtuar të fatkeqësive duke pyetur komunitetin e zonave të banimit, bizneset dhe grupet e interesit.

· U zhvilluan takime me persona kyç dhe u plotësuan pyetësorë për të marrë të dhënat referencë për hartimin e strategjisë.

· Grupi i punës, i mbështetur nga kompania konsulente, hartoi dokumentin e strategjisë bazuar në të dhënat e mbledhura dhe konsultimet e kryera.

4. Gjatë periudhës së punës së këtij Grupi Teknik u bënë disa dëgjesa publike, veçanërisht për konsultimin e planit të veprimit të strategjisë me qëllim rregullimin e pasaktësive të mundshme dhe finalizimin e dokumentit. Në këto dëgjesa u ftuan të merrnin pjesë komuniteti lokal, bizneset dhe grupet e interesit, duke siguruar një përfshirje të plotë dhe të gjithanshme.

5. Dëgjesat publike dhe takimet me komunitetin lokal, bizneset dhe grupet e interesit ndihmuan në diskutimin dhe rafinimin e draftit të Strategjisë Vendore për ZRF. Këto konsultime siguruan identifikimin e sfidave kryesore dhe përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të rëndësishëm në procesin e hartimit të strategjisë.

6. Për të siguruar një qasje të koordinuar në nivel rajonal, u organizuan takime ndërmjet kryetarëve të bashkive të Qarkut Fier dhe Prefektit. Synimi ishte integrimi i Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë në politikat dhe planet rajonale, duke siguruar harmonizimin e strategjisë vendore me objektivat më të gjera të qarkut.

7. Me përfundimin e dëgjesës së fundit të zhvilluar u mbyll cikli i dëgjesave dhe Grupi Teknik finalizoi dokumentin në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile". Dokumenti reflekton kontributet e marra gjatë procesit të konsultimit dhe synon të përmirësojë aftësinë e bashkisë për të menaxhuar dhe zvogëluar risqet nga fatkeqësitë.

8. Dokumenti do të shërbejë si një udhërrëfyes kyç për Planifikimin e Zhvillimit Urban, duke integruar masat për ZRF. Ky integrim do të sigurojë që planifikimi urban dhe zhvillimi i bashkisë të marrë në konsideratë rreziqet natyrore dhe mjedisore, duke mbrojtur komunitetin dhe duke rritur qëndrueshmërinë e tij.

9. Ky dokument është themelor për përmirësimin e aftësisë së bashkisë për të menaxhuar risqet nga fatkeqësitë, por në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019, ai duhet të rishikohet dhe përmirësohet vazhdimisht, për t'u përshtatur me ndryshimet e mundshme në sfidat dhe rreziqet që mund të shfaqen.

10. Grupi Teknik vlerëson se dokumenti "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2023-2030", është i përfunduar dhe përfaqëson një dokument cilësor që i paraqitet kësaj bashkie, ndaj mendojmë dhe kërkojmë miratimin e tij nga Këshilli i Bashkisë Patos.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e dhjetë

Projekt-vendim “Për miratimin e dokumentit “Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani veprimit 2024-2030” në territorin e bashkisë Patos.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro .

SEKRETARE
Refaela Xeba



Enkelejd Ajazi
Ajazi

Smerald Hoxhey
Hoxhey

Vjollca Lary
Lary

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 433/3 Prot.

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-Vendim “Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2024-2025”.

Armand Ahmetaj- Po më vijnë propozime nga këshillatrët që e njohin dokumentin dhe mos të relatohet. Në qoftë se njiheni me materialin kalojmë direkt ne votim nëse ka diskutime.

Këshilltari z. Eduart Faslliaj largohet nga salla.

Armand Ahmetaj –Unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e njëmbëdhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e projektvendimit “Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2024-2025”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro .

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 4399 Prot.

13

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-Vendim “Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025”.

Elda Goxhaj- Drejtore Arsimit -Bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikës 8 të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, si dhe planizimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 7228/20 prot., të datës 08.11.2024 dhe Urdhrit nr. 272, datë 11.11.2024 të Kryetarit të Bashkisë “Për krijimin e komisionit të shqyrtimit të dosjeve të nxënësve të shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale për bursë për vitin arsimor 2024-2025, Komisioni shqyrtoi dokumentacionet e 83 aplikantëve. Duke marrë në konsideratë dokumentacionin e duhur për nxënësit që kanë aplikuar, si dhe numrin e 15 bursave të plota të akorduara për Bashkinë Patos, i paraqet Këshillit Bashkiak, për të votuar listën emërore të aplikantëve:

Komisioni i Arsimit pasi u njoh me listën e aplikantëve të ekzekutivit, vendosi të miratojë përgjysmimin e 15 bursave të plota të akorduara për Bashkinë Patos, në 30 gjysëmbursa për këto kategori aplikantësh :

4 familje që kanë nga 3 nxënës jetim, do të marrin nga dy gjysëmbursa, 7 familje që kanë nga 2 nxënës jetim, do të marrin nga 1 gjysëmbursë dhe 12 familje që kanë nga 1 nxënës jetim do të marrin nga 1 gjysëmbursë. Ndërsa 3 gjysëmbursa do të shpërndahen për 3 nxënës që kanë problematika specifike sociale, bazuar në kriteret e VKM-së, të cilët janë nxënës me AK dhe të braktisur nga njëri prind ose nxënës me status jetimi dhe humbje kujdestarie.

Armand Ahmetaj - Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e dymbëdhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025”.

Këshilltarja Elmira Rama Largohet nga salla.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro .

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 43921 Prot.
13

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12..2024 ora 10:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së trembëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-Vendim “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025”.

Kryetari i Bashkisë- Duke qënë se është marrë pjesa e bazës materiale nga fondi Shqipetar i Zhvillimit për ndërtimin nga e para të shëtitores në lagjen e Re për mbylljen e punimeve duke qënë se ato janë me afat 3-6 muaj dhe duke qënë se ne kemi planifikimet tona në buxhetin e ardhshëm dhe që ti realizojmë të gjitha në kohe ne morëm minimumin e mundshëm 10 punonjës.

Armand Ahmetaj - Unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e trembëdhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro .

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3909 Prot.
4

Patos më 26.12.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.12..2024 ora 10:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt vendim “Për Dhënien e dakordësisë për rinovimin e kontratës së qirasë të miratuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2024 të Këshillit të Bashkisë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier”.

Armand Ahmetaj nëse jeni dakord kalojmë në votim Projekt vendim “për Dhënien e dakordësisë për rinovimin e kontratës së qirasë të miratuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2024 të Këshillit të Bashkisë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro .

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj